



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:911920
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05388714

C.nr.1100/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M F nga Gj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shabi Isufi avokat nga Gjilani, kundër të paditurës B K e S me seli në P, me objekt kontesti kompensim i dëmit jo material, pas mbajtes së seancës së shqyrtimit kryesor më datë 17.01.2024 dhe pas pranimit të shpjegimeve përfundimtare, më datë 07.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit M F nga Gj, kundër të paditurës B K e S me seli në P, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 12.09.2011, t'ia paguaj edhe atë:

- për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 1,800.00 euro;
- për dhimbje fizike shumën prej 2,100.00 euro;
- për frikë të përjetuar shumën prej 1,650.00 euro;
- për shëmtimin trupor shumën prej 1,350.00;

Në shumë të përgjithshme prej 6,900.00 euro, të gjitha këto, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 05.02.2024 (si datë e nxjerrjes së aktgjykimit), e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Fillimisht në këtë çështje kontestimore, paditësi M F nga Gj, përmes të autorizuarit të tij, më datë 19.03.2013 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurave K e S "S", me seli në P dhe B K e S me seli në P, me objekt kontesti kompensim i dëmit.

Lidhur me këtë çështje, është vendosur në mënyrë meritore me Aktgjykimin C.nr. /2013 të datës 12.12.2018, ndaj të cilit aktgjykim është paraqitur ankesë nga palët ndërgjyqëse, ku Gjykata e Apelit me Aktvendimin AC.nr. /2019 të datës 27.07.2023, i ka APROVUAR ankesat

e palëve ndërgjyqëse, dhe e ka PRISHUR Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C.nr. /2013 të datës 12.12.2018, dhe lëndën ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

I autorizuari i paditësit avokat Shabi Isufi me parashtresën e datës 27.03.2019, e ka njoftuar gjykatën për tërheqjen e padisë ndaj të paditurës së parë Kompania e Sigurime “S”, me seli në P, pasi që me të njëjtën kanë arritur Aktmarrëveshje jashtëgjyqësore.

Në procedurën e rigjyimit, gjykata ka mbajtur dhe zhvilluar shqyrtimin gjyqësor nga fillimi, duke mbajtur seancë përgatitore dhe seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes, për t’i shqyrtuar të gjitha çështjet që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj.

Pretendimet e palëve:

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, në procedurën e rigjyimit ka theksuar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe thënieve nga seancat e kaluara, precizimet e saj dhe fjalës përfundimtare dhe i njëjti ka deklaruar se me datë 12.09.2011 rreth orës 19:55 min, ka ndodhur aksident trafiku, ku Njësiti “A”, automjeti i udhëtarëve me targa të regjistrimit 06-44-BB, gjatë lëvizjes në relacionin Gj-M, me të arritur përtballë Marketit “..”, te hyrja e dytë, në autoparkungun e këtij marketi, përnjëherë dredhon majtas automjetin pa u siguruar se me një veprim të tillë do ti rrezikojë pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, dhe me këtë rast ndeshet me motoçikletën Njësiti “B”, i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur në drejtim të kundërt dhe duke e vërejtur rrezikun para kontaktit frenon 7.5m, dhe përplasat me derën e pasme dhe në krahun e pasëm të anës së djathtë të Njesisë “A”, ku si pasojë e këtij lëndimi, lëndime fatale pëson drejtuesi i motoçikletës, ndërsa lëndime të rënda trupore pëson paditësi M F., në cilësinë e pasagjerit në motoçikletë dhe i njëjti detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore në Qendrën Emergjente në Spitalin e Gjilanit, dhe pas kësaj udhëzohet për QKUK në Prishtinë, ku edhe trajtohet për shërim të mëtutjeshëm, si në Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale ku konstatohet se paditësi ka pësuar thyerje të nofullës së poshtme në regjionin e simfizës me dislokim të anës së majtë, si dhe thyerje të eshtrave të hundës, pastaj sipas lëndimeve në vesh me të cilin konstatohet se ka humbur të dëgjuarit ku i njëjti bën kontrolla të njëpasnjëshme, dhe së fundi detyrohet të qëndroj në QKUK në Prishtinë, Reapartin e Traumatologjisë pasi që i njëjti për shkak të shërimit joadekuat të trupit të mandibullës nga ana e djathtë, ndërmjet dhëmbit 32,33 si pasojë e frakturës së mandibullës në aksidentin e trafikut.

Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën, t’ia kompensoj shumën prej 30% nga shuma e kërkuar në fjalën përfundimtare në lartësi prej 23,000.00 euro dhe atë: shumën prej 1,800.00 euro për zvogëlim të aktivitetit jetësore, shumën prej 2,100.00 euro për dhimbje fizike, shumën prej 1,650.00 për frikë të përjetuar dhe shumën prej 1,350.00 për shëmtimin trupor.

Shpenzimet e procedurës, i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar, edhe atë: të kompensoj 30% nga shuma e gjykuar në lartësi prej 1,317.40 euro, shumën prej 395.00 euro për veprime t e bëra para kësaj seance sipas Aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.249/13, si dhe

të obligoj të paditurën BKS në bartjen e shpenzimeve për një seancë të tanishme në shumë prej 135.00 euro, e në shumë të përgjithshme prej 530.00 euro.

E paditura, në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe në shpjegimet përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit, si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, pasi që sa i përket bazës e kontestojmë për dy arsye: e para se në bazë të nenit 11.1.4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashihet që nuk ofrohet mbulesë siguroese dhe nuk ka të drejtën e dëmshpërblimit bashkudhëtari që me vullnetin e vet ndodhet në një mjet të pasiguruar me të cilin është shkaktuar aksidenti, e mbi bazën e kësaj paditësi në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë bashkudhëtar i motoçikletës e cila ka qenë e pasiguruar dhe për këtë rrethanë ka qenë në dijeni vet paditësi për shkak se motoçikleta nuk ka pasur targa të vendosura dhe e njëjta ka theksuar që në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim pasi që aksidenti ka ndodhur me datë 12.09.2011, ekspertiza penale e komunikacionit është përpiluar me datë 01.11.2011, ekspertiza private e komunikacionit është përpiluar me datë 08.05.2012, ndërsa zgjerimi i padisë ndaj BKS-së është bërë me datë 07.07.2015 pra 3.8 vite nga aksidenti, 3.7 vite nga ekspertiza penale apo 3.1 vite nga ekspertiza private. Pra sipas të paditurës paditësi brenda 3 viteve prej kur i është shkaktuar dëmi e ka ditur për dëmin dhe për kryerësin e dëmit kurse për kompensim dëmi padinë e ka zgjeruar pas kalimit të afatit ligjor, andaj nuk ka kushte për zbatimin e afatit objektiv prej 5 viteve për paraqitje të padisë siç e parasheh neni 3.7.6.2 i LMD-së të RSFj-së(1978), e as të afatit të privilegjuar sipas nenit 377 të të njëjtit ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjendja faktike e vërtetuar:

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Vërtetimi nr.27 i datës 15.12.2011, në emër të M. F. i lëshuar nga Sh.M. “M. B.”, në Gj.; Qertifikata e shtetësisë dhe e lindjes në emër të M. F.; Raporti policor i datës 12.09.2011 nga vendi i ngjarjes me rastin e ndodhjes së aksidentit me skicën bashkangjitur raportit; Raporti mbi tërheqjen e automjetit i datës 12.09.2011; Kuponi i pagesës nr.036653 i lëshuar mne datë 21.10.2011, për shumën në lartësi prej 3.30 euro, për mbrojtësen e veshëve e ka lëshuar nga “Aloe Farm”; 10 kupona fiskal të shpenzimeve të shërimit; Aktgjykimi penal i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan P.nr.31.12.2013; Ekspertiza nga lëmia e komunikacionit e datës 01.11.2011 e ekspertit Besim Ibrahim; Ekspertiza nga lëmia e komunikacionit e datës 08.05.2012 e ekspertit Yll Koshi nga Prishtina; Ekspertiza nga lëmia e otorinolaringologjie e datës 03.10.2016 e ekspertit dr.Aziz Mustafa; Ekspertiza nga lëmia e psikiatrisë e datës 04.12.2016 e ekspertit dr. Afrim Cana; Super ekspertiza e datës 20.02.2017 e ekspertëve dr.Hajdin Thaçi, Arsim Kelmendi dhe Faton Morina; Raporti i Qendrës Spitalore në Prishtinë i datës 30.10.2017 dhe Raporti i datës 31.10.2017.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç e të gjitha ato së bashku dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase:

- Nga ekspertiza e komunikacionit e datës 01.11.2011, e ekspertit Besim Ibrahim, gjykata vërtetoi faktin se deri të fatkeqësia në komunikacionin rrugor ka ardhur kur drejtuesi i automjetit Peugeot French, i cili ka qenë duke lëvizur në rrugën Gjilan-Preshevë, me të arritur te Qendra Tregtare “ETC”, fillon kthimin majtas në udhëkryq pa u siguruar mirë për komunikacionin e kahjes së kundërt dhe ndeshet me motoçikletën Aprilia Sportpro i cili ka qenë duke lëvizur në kahje të qendrës së qytetit. Gjatë kohës së kthimit majtas ngasësi i veturës ka qenë duke zhvilluar shpejtësinë prej 15km/h.

Ngasësi i motoçikletës ka qenë duke lëvizur në drejtim të qendrës së qytetit dhe ka pasur kahjen e lëvizjes drejt dhe në momentin e reagimit ka qenë duke zhvilluar shpejtësinë e lëvizjes 63km/h, kurse në momentin e kontaktit me automjet ka pasur shpejtësinë e kontaktit 30km/h.

Rruga e ndaljes së motoçikletës është 21.5m.

Nëse gjykata konstaton që për atë pjesë të rrugës shpejtësia e kufizuar e lëvizjes është 40km/h, ngasësi i motoçikletës Aprilia Sportpro ka dështuar ti përmbahet shpejtësisë së kufizuar të lëvizjes duke kontribuar në shkaktimin e fatkeqësisë në komunikacion. Si pasojë e këtij aksidenti lëndime fatale për jetë pëson drejtuesi i motoçikletës ndërsa lëndime trupore pësojnë edhe drejtuesi i automjetit Peugeot si dhe pasagjeri i motoçikletës Aprilia Sportpro këtu paditësi.

-Nga ekspertiza e komunikacionit e ekspertit Yll Koshi e datës 08.05.2012, gjykata vërtetoi faktin se sipas kësaj ekspertize shkaktar i këtij aksidenti janë të dy pjesëmarrësit në këtë aksident me lëshimet e tyre, si:

-Lëshimet e ngasësit të veturës “A” të markës Peugeot janë: mosrespektimi i përparësisë së kalimit ndaj motoçikletës “A”, të markës Aprilia.

Hyrja në udhëkryq pa pasur të sigurve përfundimin e qkyqjes nga rruga.

-Lëshimet e ngasësit “B” të motoçikletës janë: ngasja me shpejtësi më të madhe se të lejuar;

Shpejtësia e papërshtatshme e lëvizjes kushteve të pamurit natën;

Ngasja pa patentshofer.

Në lartësinë e pasojave të këtij aksidenti përpos shpejtësisë së madhe të motoçikletës ka kontribuar edhe mosmbajtja eventuale e helmetës mbrojtëse të kokës të ngasësit dhe të pasagjerit në motoçikletë.

Baza ligjore:

Gjykata, në këtë çështje kontestimore ka aplikuar dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, (RSFJ-1978), neni 360, në të cilin thuhet se: “*Me parashkrim pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen. e detyrimit. Gjykata nuk mund të përfillë parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë*”, nenin 376, paragrafi 1 përcakton se: “*Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin*”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës:

Meqë e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesëpadisë së paditësit, gjykata e vlerësoi këtë pretendim dhe gjeti se kërkesa e paditësit është e parashkruar.

Pasi që, nga kjo gjendje faktike, gjykata ka konstatuar se paditësi zgjerimin e padisë ndaj të paditurës BKS e ka bërë pas afatit, gjegjësisht me datë 07.07.2015, pra 3.8 vite pas aksidentit të ndodhur me datë 12.09.2011 në të cilin aksident paditësi kishte pësuar lëndime trupore, po ashtu paditësi me datë 01.11.2011 ka mësuar përmes ekspertizës së komunikacionit të punuar në procedurë penale, se *“kontribut në shkaktimin e aksidentit ka dhënë edhe motoçikleta që ka qenë pa sigurim”*, pra paditësi që nga data 01.11.2011 pasi që në këtë procedurë ka qenë në cilësinë e të dëmtuarit ka mësuar edhe për shkaktarët e dëmit dhe e ka ditur që kontribut në dëmin e shkaktuar ka dhënë edhe ngasësi i motoçikletës, andaj duke e ditur për përgjegjësinë e ndarë dhe për shkaktarët e dëmit, zgjerimin e padisë e ka bërë pas kalimit të afatit pra pasi që kanë kaluar 3.7 vite pas marrjes në dijeni për dëmin dhe për personin që e ka shkaktuar dëmin.

Gjykata vlerësoi se kërkesëpadisë nuk i del themelësia, pasi e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës, ashtu që gjykata fillimisht konstatoi se është fakt i pakontestueshëm se me datë 12.09.2011 rreth orës 19:55 min, ka ndodhur aksident trafiku, ku Njësiti “A”, automjeti i udhëtarëve me targa të regjistrimit 06-44-BB, gjatë lëvizjes në relacionin Gjilan-Muçibabë, me të arritur përballë Marketit “ETC”, te hyrja e dytë, në autoparkimun e këtij marketi, përnjëherë drejton majtas automjetin pa u siguruar se me një veprim të tillë do ti rrezikojë pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, dhe me këtë rast ndeshet me motoçikletën Njësiti “B”, i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur në drejtim të kundërt dhe duke e vërejtur rrezikun para kontaktit frenon 7.5m, dhe përplasat me derën e pasme dhe në krahun e pasëm të anës së djathtë të Njesisë “A”, ku si pasojë lëndime fatale pëson drejtuesi i motoçikletës, ndërsa lëndime të rënda trupore pëson paditësi Mërgim Fazliu, në cilësinë e pasagjerit në motoçikletë dhe i njëjti detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore në Qendrën Emergjente në Spitalin e Gjilanit, dhe pas kësaj udhëzohet për QKUK në Prishtinë, ku edhe trajtohet për shërim të mëtutjeshëm, ashtu që duke u bazuar në nenin 321, paragrafi 2 të LPK-së, që përcakton se *“Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”*, vlerësoi se nuk ka nevojë të provohet se ka ndodhur aksidenti i trafikut ku paditësi Mërgim Fazliu ka qenë në cilësinë e pasagjerit në motoçikletën Aprilia Sportpro, ku në momentin e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, meqë u pohua nga të dy palët ndërgjyqëse.

Meqë, zgjerimi i padisë është paraqitur më datë 07.07.2015, pas afër 3.8 viteve nga data e krijimit të marrëdhënieve të detyrimeve mes palëve prej se kur është shkaktuar dëmi me datë 12.09.2011, ndërsa dispozitat ligjore nga ligji i aplikueshëm përcaktojnë se kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin i cili e ka shkaktuar”, (neni 376 par.1 i LMD-së), gjykata vendosi të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi nuk gjeti se për kërkesën e paditësit rrjedh tjetër afat, nga ai i përcaktuar me ligj.

Andaj, pasi që padituri ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit mbi bazën e parashkrimit dhe në nenin 360, të LMD-së, është përcaktuar se gjykata e merr parasysht parashkrimin vetëm në qoftëse debitori (këtu i padituri) thirret në të.

Për shpenzimet e procedurës gjykata, ka vendosur në bazë të nenit 452, paragrafi 1 dhe 463, paragrafi 1 të LPK-së, pasi që paditësi e ka humbur kontestin, ndërsa e paditura nuk i ka specifikuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartëcekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 par. 1 të LPK-së.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1100/2023, më datë 07.02.2024

Gjyqtarja,
Floriqe Qerimi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.